



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 5849/3, Prot.

Tiranë, më 04.12.2019

L ë n d a : *Kthim përgjigje shkresës tuaj nr.4468 prot., datë 27.11.2019*

ZNJ. ORNELA ZONJA

**SEKRETARE E PËRGJITHSHME
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS.**

TIRANË

E nderuara znj. Zonja,

Në përgjigje tuajës nr.4468 prot., datë 22.11.2019, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) me nr.5849/2 prot., datë 27.11.2019, në të cilën kërkonti informacion shtesë mbi azhurnimin e të dhënave për listat e kandidatëve të përcjella nga KLGJ, ju informojmë për sa më poshtë:

Së pari, lista e kandidatëve, nga radhët e gjyqtarëve, që plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2020, të dërguara nga KLGJ me shkresën nr.5693 prot., datë 15.11.2019, është përpiluar në përputhje me përcaktimet e nenit 221, pika 1, e Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar. Lista është dërguar në drejtim të institucionit të Presidentit të Republikës, brenda afatit të përcaktuar nga neni 221, pika 3, e ligjit të sipërcituar, konkretisht, brenda datës 15 nëntor të çdo viti kalendarik.

Në këtë listë, të dërguar nga KLGJ më datë 15 nëntor, ka patur të përfshirë edhe dy gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës z. Arben Vrioni dhe z. Arjan Balliu, për shkak se deri në atë datë, nuk ka pasur ndonjë shkak ndalimi të tyre për t'u përfshirë në listë. Shkaku i ndalimit të përfshirjes së tyre ka lindur pas datës 15 nëntor, afat ky i fundëm që ligji ka ngarkuar KLGJ për të realizuar këtë proces. Megjithatë, lista e dërguar ka pasur të përfshirë informacionin të cilin KLGJ e dispononte deri në atë moment, lidhur me gjyqtarin Arjan Balliu, ku në faqen 2 të listës është theksuar se "Gjyqtari Arjan Balliu është në proces të rivlerësimit kalimtar dhe nga njoftimi i bërë publik në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit më datën 18.11.2019 shpallet vendimi."

Në kushtet kur gjyqtarët e mësipërm, z. Arben Vrioni dhe z. Arjan Balliu, janë shkarkuar nga detyra me vendim të Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, si dhe bazuar në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", konsiderohen të pezulluar nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, ato duhet të mos përfshihen në shortin për t'u zgjedhur si anëtarë të KED-së.

Së dyti, Ligji nr. 96/2019 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar në pikën 2 të nenit 158, se: “Prokuroria, në rast se fillon hetimet penale ndaj magjistratit, njofton menjëherë Këshillin respektiv.”. Deri në përgatitjen e kësaj liste pranë KLGJ-së nuk është përcjellë asnjë informacion nga prokuroria lidhur me gjyqtarët për të cilët ka nisur hetimi penal.

Për sa më sipër, KLGJ i ka kërkuar këtë informacion pranë Prokurorisë së Përgjithshme e cila me shkresën nr. 3141/25 prot., datë 04.12.2019, dërgon të gjithë informacionin e dërguar pranë saj nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësor dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Nga ky informacion i dërguar konstatohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka si persona nën hetim gjyqtarët:

1. Aleks Nikolli, në procedimin nr.30, datë 13.02.2019;
2. Skënder Damini, në procedimin nr. 30, datë 13.02.2019;
3. Petrit Aliaj, në procedimin nr. 30, datë 13.02.2019.

Nisur nga sa më sipër, theksojmë se gjyqtarët Aleks Nikolli dhe Skënder Damini, të përfshirë në listën e dërguar nga KLGJ më 15.11.2019, duhet të **mos përfshihen në shortin për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi** për shkak të kushtit të ndalimit për t’u përfshirë në këtë listë pasi janë persona nën hetim. Ndërkohë, gjyqtari Petrit Aliaj, është përjashtuar nga përfshirja në listën e dërguar në drejtimin tuaj, për shkak se njëri prej vlerësimeve të tij për anën profesionale dhe etike ka qenë në nivelin “mirë”.

Së treti, lidhur me ankimin e paraqitur nga z. Medi Bici, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.250 datë 26.11.2019, ka vendosur pushimin gjykimin për këtë çështje. Për këtë shkak përjashtimi i tij nga shorti për t’u zgjedhur anëtar i KED-së konsiderohet i drejtë.

Gjithashtu lidhur me shkresën tuaj nr. 4520 prot., datë 02.12.2019 ju bëjmë me dije se nga ana KLGJ-së, pjesëmarrës në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së më datë 5 dhjetor 2019, do të jetë zëvendëskryetari i këtij institucioni z. Maksim Qoku.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARE


NAUREDA LLAGAMI
